



Nr. 1810/296Prot

Tiranë më 30.06.2026

**Drejtuar:** Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit  
Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë  
Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin  
Parlamentar për Integrimin European  
Këshillit të Investimeve  
Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri  
Drejtorisë së Përgjithshme për Tregun e Brendshëm, Industrinë, Sipërmarrjen  
dhe NVM-të (DG GROW) – Komisioni European

---

**Lënda:** Komete dhe rekomandime mbi Projektvendimin “*Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030*” dhe Planin e Veprimit shoqërues

**Të nderuar,**

AREA – Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme, pasi shqyrtoi Projektvendimin “*Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030*”, Relacionin Shpjegues dhe dokumentacionin shoqërues, dëshiron të paraqesë komentet dhe rekomandimet e saj në kuadër të procesit të konsultimit publik.

AREA vlerëson pozitivisht nismën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030, si një dokument i rëndësishëm politikash që synon të mbështesë transformimin industrial të Shqipërisë, forcimin e konkurrueshmërisë, integrimin në zinxhirët europianë të vlerës, zhvillimin e inovacionit dhe tranzicionin e gjelbër e digjital.

Gjithashtu, AREA vlerëson harmonizimin e strategjisë me orientimet kryesore të politikës industriale të Bashkimit European dhe me objektivat e Kapitullit 20 “*Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale*” në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European.

---

**Adresa:** Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

**Website:** [www.areasso.org](http://www.areasso.org)

**Email:** [info@areasso.org](mailto:info@areasso.org)

**Tel:** +355 (0)68 60 61 210



Megjithatë, pas analizimit të dokumentit, AREA vlerëson se strategjia mbetet kryesisht në nivel orientues dhe deklarativ, ndërkohë që kërkon forcim të konsiderueshëm në aspektin e sigurisë juridike, instrumenteve konkrete të zbatimit, mbështetjes financiare dhe garantimit të një klime të qëndrueshme investimesh.

## **I. SIGURIA JURIDIKE DHE STABILITETI RREGULLATOR**

AREA konsideron se siguria juridike përbën një nga shtyllat themelore të zhvillimit industrial dhe tërheqjes së investimeve afatgjata.

Përvoja e sektorit energjetik shqiptar gjatë periudhës 2007–2026 ka treguar se ndryshimet e shpeshta ligjore, rregullatore dhe administrative, të ndërmarra shpesh pa një analizë të plotë të ndikimit mbi investimet ekzistuese dhe pa respektuar në mënyrë të mjaftueshme parimin e sigurisë juridike, kanë krijuar pasiguri për investitorët dhe kanë ndikuar negativisht në klimën e biznesit.

Kjo eksperiencë eidenton nevojën që Strategjia Kombëtare e Industrisë të mos kufizohet vetëm në përcaktimin e objektivave ekonomike apo të instrumenteve financiare afatshkurtra, por të shërbejë si një dokument themelor zhvillimi, i ndërtuar mbi parime të qëndrueshme dhe afatgjata.

AREA vlerëson se një strategji kombëtare zhvillimi nuk mund dhe nuk duhet të trajtohet si një plan afatshkurtër ekonomik apo si një instrument i orientuar vetëm drejt treguesve financiarë të momentit. Përkundrazi, ajo duhet të përfaqësojë themelet mbi të cilat ndërtohet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe industrial i vendit.

Në këtë kuadër, Strategjia duhet të krijojë kushte të qëndrueshme zhvillimi, të mbështetura në sigurinë juridike, stabilitetin institucional dhe parashikueshmërinë rregullatore, të cilat të garantojnë besimin e investitorëve jo vetëm për projektet aktuale, por edhe për investimet që do të realizohen në dekadat e ardhshme.

Zhvillimi industrial kërkon investime me horizonte shumëvjeçare, shpesh me cikle kthimi kapitali që kalojnë 10–20 vjet. Për këtë arsye, stabiliteti institucional dhe rregullator është po aq i rëndësishëm sa incentivat financiare apo fiskale.

AREA rekomandon që Strategjia të përfshijë në mënyrë të qartë parimet e:

- sigurisë juridike;
- mbrojtjes së investimeve ekzistuese;
- respektimit të të drejtave të fituara ligjërisht;
- parashikueshmërisë rregullatore;
- stabilitetit institucional afatgjatë;
- konsultimit sistematik të sektorit privat për çdo ndryshim me ndikim në aktivitetet prodhuese dhe industriale.

---

**Adresa:** Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

**Website:** [www.areasso.org](http://www.areasso.org)

**Email:** [info@areasso.org](mailto:info@areasso.org)

**Tel:** +355 (0)68 60 61 210



Vetëm mbi këto parime mund të ndërtohet një bazë e qëndrueshme zhvillimi industrial, në përputhje me praktikën më të mira europiane dhe me objektivin strategjik të integritetit të Shqipërisë në tregun e përbashkët europian.

## **II. ENERGJIA SI FAKTOR KONKURRUESHMËRIE DHE ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS ENERGJETIKE**

AREA vlerëson se energjia përbën një nga faktorët më të rëndësishëm të konkurrueshmërisë industriale dhe se zhvillimi i industrisë shqiptare është i lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e infrastrukturës energjetike kombëtare.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se Strategjia duhet të vendosë një fokus më të fortë jo vetëm mbi tranzicionin e gjelbër dhe dekarbonizimin, por edhe mbi:

- zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes;
- rritjen e kapaciteteve të menaxhimit të energjisë së prodhuar dhe të konsumuar;
- digjitalizimin e sistemit energjetik;
- zhvillimin e kapaciteteve të depozitimit të energjisë;
- integrimin gradual të mekanizmave modernë të tregut në përputhje me nivelin real të zhvillimit të sistemit energjetik shqiptar.

AREA konsideron se procesi i harmonizimit me tregun europian të energjisë duhet të bazohet në kushtet reale të sistemit energjetik shqiptar dhe jo në transplantimin automatik të modeleve të hartuara për sisteme energjetike shumë më të zhvilluara.

Përvoja e viteve të fundit ka treguar se krijimi i mekanizmave të rinj të tregut pa ekzistencën paraprake të infrastrukturës së nevojshme fizike dhe institucionale mund të rrisë kostot për investitorët dhe konsumatorët pa sjellë përfitimet e pritshme në aspektin e konkurrencës dhe eficiencës.

Një shembull tipik është zhvillimi i tregut të disbalancave. Në kushtet aktuale të sistemit energjetik shqiptar, pjesa dërrmuese e fleksibilitetit operacional dhe e balancimit të sistemit vazhdon të sigurohet në praktikë nga KESH, i cili luan funksionin e stabilizuesit kryesor të sistemit elektroenergjetik kombëtar.

Për këtë arsye, AREA vlerëson se gjatë fazës së tranzicionit mund të ishte më efikase që KESH të vazhdojë të ushtrojë këtë rol në mënyrë të organizuar dhe transparente, duke reflektuar kostot reale të shërbimit, ndërkohë që zhvillohen gradualisht:

- infrastruktura e tregut;
- sistemet e matjes dhe monitorimit;
- kapacitetet e depozitimit;
- agregatorët;
- operatorët e fleksibilitetit;

---

**Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane**

**Website:** [www.areasso.org](http://www.areasso.org)

**Email:** [info@areasso.org](mailto:info@areasso.org)

**Tel:** +355 (0)68 60 61 210



- pjesëmarrësit e rinj në tregun e balancimit.

Vetëm pas krijimit të këtyre kushteve mund të arrihet një treg balancimi realisht konkurrues, me pjesëmarrje të gjerë të aktorëve të ndryshëm dhe me mekanizma që sjellin eficiencë ekonomike reale për sistemin.

AREA vlerëson se rregullat e tregut duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të optimizojnë investimet ekzistuese dhe kapacitetet prodhuese të vendit, duke shmangur krijimin e kostove shtesë që ulin eficiencën e operimit të aseteve energjetike dhe cenojnë konkurrueshmërinë e industrisë shqiptare.

Në këtë kuadër, rekomandojmë që Strategjia të përfshijë masa konkrete për:

- modernizimin e rrjeteve energjetike;
- reduktimin e kufizimeve operative në rrjet;
- zhvillimin e kapaciteteve të depozitimit të energjisë;
- krijimin gradual të tregjeve të fleksibilitetit;
- zhvillimin e mekanizmave të balancimit në përputhje me maturimin real të tregut dhe infrastrukturës energjetike shqiptare.

### III. MBËSHTETJA FINANCIARE E INDUSTRIËS

Strategjia përmend nevojën për krijimin e një arkitekture financiare industriale, por nuk përcakton instrumente konkrete.

AREA rekomandon:

- krijimin e Fondit Kombëtar për Modernizimin Industrial;
- skema garancie sovrane për investimet prodhuese;
- financime për digjitalizimin industrial;
- fonde për inovacion dhe kërkim industrial;
- mekanizma mbështetës për NVM-të prodhuese.

### IV. PARTNERITETI ME SEKTORIN PRIVAT

Strategjia identifikon fragmentimin institucional si një nga sfidat kryesore.

AREA rekomandon ngritjen e një mekanizmi të përhershëm konsultimi ndërmjet:

- qeverisë;
- organizatave të biznesit;
- investitorëve;

---

**Adresa:** Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

**Website:** [www.areasso.org](http://www.areasso.org)

**Email:** [info@areasso.org](mailto:info@areasso.org)

**Tel:** +355 (0)68 60 61 210



- universiteteve;
- institucioneve kërkimore.

Përfaqësuesit e industrisë duhet të përfshihen sistematikisht në proceset e hartimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave industriale.

## **V. ZHVILLIMI I ZONAVE INDUSTRIALE DHE ZINXHIRËVE TË VLERËS**

AREA mbështet qasjen e ekosistemeve industriale dhe integrimin në zinxhirët europianë të vlerës.

Megjithatë rekomandojmë:

- zhvillimin e parqeve industriale moderne;
- infrastrukturë energjetike dhe logjistike të dedikuar;
- lehtësimin e procedurave për investimet prodhuese;
- mbështetje për certifikimet europiane dhe ndërkombëtare.

## **VI. INTEGRIMI EUROPIAN DHE INVESTIMET STRATEGJIKE**

AREA vlerëson veçanërisht orientimin e Strategjisë drejt integrimit në ekosistemet industriale europiane dhe zhvillimit të industrive me vlerë të shtuar më të lartë.

Në këtë kuadër rekomandojmë që:

- instrumentet IPA III;
- Western Balkans Investment Framework (WBIF);
- programet Horizon Europe;
- programet e inovacionit industrial të BE-së;

të përdoren në mënyrë më të strukturuar dhe të orientuar drejt projekteve prodhuese dhe industriale.

## **PËRFUNDIME**

AREA mbështet hartimin e Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030 dhe vlerëson përpjekjet për harmonizimin e politikave industriale shqiptare me *acquis communautaire* dhe prioritetet strategjike të Bashkimit Europian.

Megjithatë, AREA vlerëson se dokumenti mbetet kryesisht në nivel deklarativ dhe strategjik, ndërsa kërkon forcim të konsiderueshëm në aspektin e masave konkrete, instrumenteve financiare, garancive për investorët dhe mekanizmave të zbatimit dhe konsideron se dokumenti duhet të forcohet më tej përmes:

---

**Adresa:** Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

**Website:** [www.areasso.org](http://www.areasso.org)

**Email:** [info@areasso.org](mailto:info@areasso.org)

**Tel:** +355 (0)68 60 61 210



- garantimit të sigurisë juridike;
- stabilitetit rregullator;
- mbështetjes së investimeve prodhuese;
- politikave energjetike konkurruese;
- instrumenteve konkrete financiare;
- përfshirjes sistematike të sektorit privat në vendimmarrje.

AREA mbetet e gatshme të kontribuojë në procesin e mëtejshëm të konsultimit dhe të bashkëpunojë me institucionet kombëtare dhe europiane për ndërtimin e një industrie shqiptare moderne, konkurruese dhe të integruar në tregun evropian dhe rekomandon që para miratimit përfundimtar të Strategjisë të përfshihen dispozita dhe masa të qarta që garantojnë sigurinë juridike, konkurrueshmërinë e industrisë, mbështetjen e investimeve prodhuese dhe zhvillimin e një baze industriale moderne, eksportuese dhe të integruar në tregun evropian.

Në përfundim, do të vlerësonim një vlerësim tuajin për sa më sipër dhe se si këto shqetësime, rekomandime do të përfshihen në këtë strategji.

Me respekt,

**SHOQATA "AREA"**

**Anita SHUSHKU**

( \_\_\_\_\_ )

Kryetare e Bordit Ekzekutiv



---

**Adresa:** Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

**Website:** [www.areasso.org](http://www.areasso.org)

**Email:** [info@areasso.org](mailto:info@areasso.org)

**Tel:** +355 (0)68 60 61 210